



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-21-0168

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

Sh R Komuna Prishtinë, i përfaqësuar nga avokati, Hamit Gashi, Prishtinë.

kundër

E paditura

NSH, K.B "Bujqësia", Prishtinë (në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1759 të datës 24 shkurt 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 janar 2022, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-13-1759 i datës 24 shkurt 2021, dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN009-0094 i datës 23 gusht 2013.**

- 3. Detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.03.2007 e deri me datë 31.01.2008, ti paguaj paditësit shumës prej 1.837,00 euro, kamatën ligjore në shumë prej 183 euro, dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit, shumën prej 208,00 euro, të cilat duhet paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 21 shtator 2013, paditësi përmes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN009-0094 të datës 23 gusht 2013, me të cilën kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.03.2007 deri 31.01.2008, në shumën prej 1.837,00 euro refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi në ankesë këtë vendim e konsideron si të kundërligjshëm, pasi që ai pohon se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Tutje në ankesë ai pohon se kishte pranuar një Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, nga ana e AKM-së, andaj duke u bazuar në këtë njoftim ai është paraqitë në procedurë të likuidimit me datë 15.10.2010, do të thotë në afatin ligjor, dhe nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës, siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN009-0094 të datës 23 gusht 2013, njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, një kopje të bilancit të suksesit për ndërmarrjen, dhe një listë të pagave të punëtorëve të muajit shkurt 2007.

Me datë 28 prill 2014, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se kërkesa e paditësit për këto tri paga është parashkruar në bazë të

nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të paraqesë në ankesën e tij se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 06 qershor 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen në mbrojtje në ankesë. Në këtë parashtresë paditësi prapë pohon se ai kishte pranuar njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 gusht 2008, dhe duke u bazuar me këtë njoftim, ai është paraqitë tek Autoriteti i Likuidimit në afatin e duhur ligjor, andaj nuk bëhet fjalë se kanë kaluar tri vite dhe nuk ka ndodhë parashkrimi i kërkesës.

Me datë 25 korrik 2014, AKP-ja e dorëzon kundërpërgjigjen në të cilën ajo i kundërshton pretendimet e paditësit, dhe pohon se letra e pranuar për ndërprerje të marrëdhënies së punës nuk pohon që çdo kërkesë e dorëzuar në procedurën e likuidimit do të pranohet automatikisht pa asnjë shqyrtim. Në këtë parashtresë AKP-ja i përsërit pretendimet e veta për parashkrimin e kërkesës.

Me datë 24 shkurt 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1759, ankesën e paditësit e refuzon si të pabazuar dhe vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë provë materiale që do të vërtetonte se ai i ka kërkuar këto paga në afatin ligjor, andaj kërkesa është parashkruar pasi që afati i parashkrimit ka rrjedhë nga 01 mars 2007 dhe ka përfunduar me 01 mars 2010, kurse paditësi kërkesën e ka parashtruar me 15 tetor 2010. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se në bazë të nenit 42.2 dhe nenit 7 të LPK, paditësi kishte barrën e provës, mirëpo ai ka dështuar të provoj se kërkesën e ka dorëzuar në afatin e duhur ligjor, andaj kjo kërkesë është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, dhe nenit 137 të LMD të vitit 1978.

Me datë 17 mars 2021, paditësi përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimi të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-13-1759 të datës 24 shkurt 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar ka të meta të shumta për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet, e posaçërisht dispozitiv i Aktgjykimit është në kundërshtim me arsyet e dhëna në Aktgjykim, ose nuk ka fare arsye për faktet vendimtare. Tutje paditësi pretendon se Shkalla e I-rë nuk i ka administruar provat të dorëzuara nga paditësi dhe ka ardhë në konstatimin e gabuar se kërkesa është parashkruar. Paditësi pretendon se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe ka vendosur në kundërshtim me të gjitha praktikat e kësaj gjykate kur ka vendosur për ish-punëtorët e tjerë të kësaj ndërmarrje të cilët kanë sjellë të njëjtat prova sikurse edhe paditësi. Tutje paditësi pohon se si rezultat i vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Paditësi në ankesën e tij i është referuar edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. Bashkë me këtë ankesë ai ka dorëzuar Aktvendime nga rastet tjera të lëshuara nga DHPGJS-ja.

Me datë 14 maj 2021, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se ajo e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit si të pabazuara. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë pohon se nuk do t'i përsërisë argumentet edhe më herët gjatë mbrojtjes në padi, pasi që kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjorë, andaj duhet të ndryshohet dhe padia të aprovohet si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 15 tetor 2010, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit, për kompensimin e pagave të pa paguara nga NSH "KB Bujqësia" (në likuidim), për periudhën nga data 01.03.2007 e deri 31.01.2008, në shumë prej 1.837,00 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Për të njëjtën bazë ligjore edhe Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e refuzon ankesën e paditësit dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit nuk i pranon si të sakta konstatimin e Autoritetit të Likuidimit dhe të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, se kërkesa është parashkruar. Kjo për faktin se kërkesa për paga është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 15 tetor 2010, dhe ajo kërkesë i përket periudhës nga data 01.03.2007 e deri në 31.01.2008, që do të thotë nuk ka kaluar afati ligjor prej 3 viteve, për të ardhë në konstatimin se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi bashkë me ankesën në shkallën e I-rë, ai ka dorëzuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN009-0094 të datës 23 gusht 2013, Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, një kopje të bilancit të suksesit për ndërmarrjen, dhe një listë të pagave të punëtorëve të muajit shkurt 2007, në të cilën listë është edhe paditësi.

Këto prova të ofruara nga paditësi, fare nuk janë administruar nga ana e Gjykatës së Shkallës së I-rë.

Paditësi e kishte pranuar Njoftimin nga AKM-ja për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, në kohën kur ende nuk kishte ndodhë parashkrimi, dhe duke u bazuar në këtë njoftim, pas fillimit të procedurës së likuidimit, ai me datë 15 tetor 2010 e paraqet kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit, në afat ligjor.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me listën e pagave të punëtorëve për muajin shkurt të vitit 2007, ai ka vërtetuar edhe lartësinë e tij të pagës mujore. Por duke marrë për bazë këtë provë, si dhe faktin se AKP-ja shprehimisht në mbrojtjen në ankesë, nuk e ka kontestuar lartësinë e kompensimit të kërkuar në emër të pagave, por AKP-ja e konteston vetëm çështjen e parashkrimit, Kolegji i Apelit, bazuar në këto prova që i ka sjellë paditësi në gjykatë, e ka aprovuar padinë e paditësit si të bazuar, dhe e ka detyruar të paditurën që ti paguaj paditësit shumën prej 1.837,00 euro, në emër të pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.03.2007 e deri me 31.01.2008.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë, përveç borxhit kryesor, ai ka kërkuar edhe kamatën ligjore, andaj pasi që paditësi është i suksesshëm në padinë e tij, në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, paditësit po ashtu i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10%, në shumë prej 183 euro, si dhe drejta në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në emër të përfaqësimit të avokatit, duke u bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, në shumë prej 208 euro, të cilat do të paguhen nga e paditura, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar duhet të ndryshohet, andaj ankesa e paditësit është e bazuar, ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, dhe padia aprovohet si e bazuar.

Nga se u tha më sipër, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 29 mars 2021, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 13 janar 2022.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues
